




SUKSESI QË REFUZOJMË

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2026



AUTOR
Armela Duka

QENDRESA
QYTETARE



NED


NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	3
2	METODOLOGJIA	4
3	KASKADA E DRINIT DHE DOMINIMI HIDRIK	4
4	TERMOCENTRALET (TEC), NGA PRODHIMI HISTORIK TE ROLI I TYRE SOT.	5
5	ENERGJIA DIELLORE ANKANDET, SUBVENCIONET DHE RRITJA E KAPACITETIT	7
6	ENERGJIA E ERËS DHE PROJEKTET E NDËRLIDHJES RAJONALE	8
7	ZHVILLIMET E REJA NË KAPACITETET PRODHUESE, HIDROCENTRALET E REJA TË LICENCUARA	9
8	PARADOKSI DIELLOR, POTENCIAL I LARTË DHE VARËSIA NGA HIDROKARBURET	9
9	PSE SHQIPËRIA ENDE VARET NGA IMPORTI DHE HIDROKARBURET?	10
10	ELEKTRIFIKIMI I TRANSPORTIT RRUGOR	11
11	Transporti urban, elektrifikimi dhe mobiliteti i qëndrueshëm	15
12	KRAHASIMI RAJONAL DHE EVROPIAN	15
13	ANALIZA SWOT E SISTEMIT ENERGJETIK SHQIPTAR	17
14	SEKTORI PRIVAT DHE DINAMIKAT E PRODHIMIT TË ENERGJISË NË VITIN 2026	19
15	AGROFOTOVOLTAIKËT DHE TOKAT ME BONITET (PRODHIM) TË ULËT.	20
16	A MUND TË MBËSHTETET SHQIPËRIA 100% NË ENERGJI TË RINOVUESHME?	20
Q	GJETJET KRYESORE	22
✓	REKOMANDIME	24
B	BIBLIOGRAFIA	25




1 HYRJE

Shqipëria prodhon pothuajse 100% të energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme, kryesisht nga hidrocentralet, të cilat përbënë rreth 93% të prodhimit total në tremujorin e parë të vitit 2026. Ky pozicion e bën vendin një nga liderët e "gjelbër" në Evropë për sa i përket prodhimit të energjisë elektrike. Megjithatë, varësia pothuajse totale nga uji e bën sistemin energjetik shumë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike.

Në vitet me reshje të pakta, prodhimi bie ndjeshëm dhe Shqipëria detyrohet të importojë energji me çmime të larta në tregjet ndërkombëtare, duke krijuar rrezik fiskal dhe mungesë sigurie për furnizimin. Në vitin 2025, prodhimi i energjisë nga Korporata Shqiptare e Energjisë Elektrike (KESH) në kaskadën e Drinit ra me 22% krahasuar me mesataren 30-vjeçare, për shkak të një viti të thatë me prurje të ulëta, duke dëshmuar se ndryshimet klimatike janë kthyer në rrezikun kryesor të sigurisë energjetike të vendit. Për këtë arsye, diversifikimi i burimeve të energjisë është kthyer në një nga prioritetet kryesore të politikave energjetike të vendit. Nga ana tjetër, edhe pse në Shqipëri kemi rreth 300 ditë me diell në vit, sektori i transportit mbetet totalisht i varur nga hidrokarburet (53.3% e naftës përdoret në transport), duke përbërë pengesën kryesore për kalimin drejt një sistemi pa hidrokarbure.

Gjatë periudhës 2021–2026, politika energjetike është zhvendosur gradualisht nga një model i përqendruar pothuajse vetëm te hidroenergjia drejt një portofoli më të larmishëm, me rritje të kapaciteteve fotovoltaike dhe projekte të reja eolike. Në këtë kontekst, raporti analizon në mënyrë të integruar transformimin e sistemit energjetik shqiptar gjatë periudhës 2021–2026. Vëmendja përqendrohet te hidroenergjia, energjia diellore dhe e erës, kapacitetet e ruajtjes, infrastruktura e rrjetit, elektrifikimi i transportit, roli i sektorit privat dhe përafrimi me kuadrin evropian. Pyetja analitike qendrore është nëse potenciali natyror dhe investimet e reja po përkthehen në një sistem më të diversifikuar, dhe më pak të ekspozuar ndaj importeve, luhatjeve klimatike dhe hidrokarbureve.

Struktura institucionale e sektorit ndahet mes disa organeve kryesore: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) harton politikat dhe menaxhon ankandet për kapacitete të reja, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) licencon operatorët, miraton tarifat dhe mbikëqyr tregun konkurrues, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) monitoron burimet dhe kontribuon në strategjinë kombëtare afatgjatë të sektorit dhe Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE) administron skemat e subvencionimit dhe programet e efencës energjetike për familjet dhe bizneset. Bashkërendimi mes këtyre institucioneve ka qenë historikisht sfida kryesore administrative e sektorit, siç u pa edhe në rastin e vonësive në licencimin e termocentraleve lundruese, ku afatet u shtynë disa herë për shkak të mungesës së koordinimit mes KESH dhe ERE.



2 METODOLOGJIA


Raporti mbështetet në një qasje të kombinuar cilësore–sasiore dhe në analizën e burimeve dytësore. Janë përdorur të dhëna dhe dokumente nga MIE, ERE, INSTAT, DPSHTRR, AKBN dhe AEE, si dhe nga institucione ndërkombëtare, ndër të tjera IEA, IRENA, EEA, Komisioni Evropian, Banka Botërore, EBRD dhe Komuniteti i Energjisë. Në aspektin sasior, metodologjia përfshin: (i) analizën e balanceve të energjisë elektrike të INSTAT (prodhimi neto, struktura teknologjike, importet, eksportet dhe humbjet) për periudhën 2021–2026; (ii) analizën e të dhënave të ERE-s mbi kapacitetet e instaluara, licencat, prodhimin dhe tarifat; (iii) statistikën e DPSHTRR-së mbi regjistrimet e mjeteve, përfshirë mjetet tërësisht elektrike dhe hibride; (iv) llogaritjet indikative të kostove operative në krahasimin “makinë me naftë kundrejt makinës elektrike”, të bazuara në çmimet mesatare të karburanteve (GlobalPetrolPrices, 2025–2026) dhe në tarifat e energjisë elektrike (ERE/OSHEE); (v) treguesit e krahasimit rajonal dhe evropian (EEA, Eurostat, Ember, ACP);

Në aspektin cilësor, metodologjia bazohet në: (i) rishikimin e dokumenteve strategjike dhe rregullatore (NECP i përditësuar, VKM-të për subvencionet, ndryshimet ligjore për mbrojtjen e tokës bujqësore, aktet e ERE-s); (ii) analizën e përmbajtjes së publikimeve dhe njoftimeve zyrtare të institucioneve (MIE, KESH, OST, DPSHTRR) dhe të mediave të specializuara; (iii) krahasimin e tregjeve energjetike të Ballkanit Perëndimor; (iv) vlerësimin kritik të politikave publike dhe (v) analizën SWOT, e cila sintetizon gjetjet e raportit sipas pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve, duke përfshirë efektivitetin e skemave të subvencionimit. Për vlerësimet indikative të kostos përdoren supozime të deklaruara në tekst, ato nuk paraqiten si projeksione zyrtare.

Kufizime të raportit lidhen me mungesën e përgjigjes nga institucionet publike lidhur me informacione të përditësuara të situatës energjetike në vend, si dhe mungesa e një regjistri të plotë publik të pikave të karikimit për automjetet elektrike; për këtë të fundit, raporti mbështetet në burimet e disponueshme (njoftime të DPSHTRR-së, platforma online të operatorëve dhe aplikacione si PlugShare, Google Maps) dhe i trajton vlerësimet si indikative.

3 KASKADA E DRINIT DHE DOMINIMI HIDRIK

Sistemi elektroenergjetik shqiptar është ndërtuar rreth kaskadës së lumit Drin, e cila përfshin tre hidrocentralet kryesore shtetërore Fierza, Komani dhe Vau i Dejës të cilat menaxhohen nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH). Këto tre impiante kanë përbërë historikisht mbi 80% të prodhimit vendas të energjisë elektrike. Për shkak të këtij përqendrimi, prodhimi vjetor i energjisë në Shqipëri mund të luhet deri në 100% nga një vit në tjetrin, në varësi drejtpërdrejt të sasisë së reshjeve (FIP Dashboard Energjia, 2026). Në



vitin 2023, hidroenergjia përbënte rreth 98% të kapacitetit total të instaluar prej 2,444 MW (Ekofin, 2026), duke e bërë Shqipërinë një prej liderëve evropianë për pjesën e energjisë së rinovueshme në prodhimin total, por edhe një prej vendeve më të ekspozuara ndaj rrezikut hidrologjik.

Kjo varësi krijon një cikël të njohur në ekonominë shqiptare, në vitet me reshje të bollshme (p. sh. 2021, me rreth 47% më shumë prodhim se mesatarja e dekadës), vendi eksporton energji dhe tregtuesit privatë realizojnë fitime të larta. Në të kundërt, në vitet e thata, rezervat energjetike bien ndjeshëm (deri në 70% nga maji në tetor, siç u vu re gjatë krizës energjetike 2022) dhe kostot e importit rriten. Kjo paqëndrueshmëri strukturore është pikënisja logjike e çdo politike diversifikimi dhe arsyeja pse energjia diellore dhe e erës konsiderohen jo thjesht si shtesa "ekologjike", por si mjete të domosdoshme për menaxhimin e rrezikut.

Tabela 1. Hidrocentralet kryesore të kaskadës së Drinit


Hidrocentrali	Viti i vënies në punë	Fuqia e instaluar (MW, indikative)	Operatori
Fierza	1978	500	KESH sh.a.
Koman	1985	600	KESH sh.a.
Vau i Dejës	1971	250	KESH sh.a.

Burimi: KESH sh. a

4 TERMOCENTRALET (TEC), NGA PRODHIMI HISTORIK TE ROLI I TYRE SOT.

Historia e termocentraleve në Shqipëri fillon në vitin 1951, me TEC-in e parë prej 2.9 MW në Tiranë. Në fillim të viteve 1990, vendi numëronte 7 termocentrale me fuqi të instaluar rreth 194 MW. Me amortizimin teknologjik dhe kostot e larta, këto impiante u mbyllën njëra pas tjetrës deri në vitin 2007, kur u mbyll edhe TEC-i i Fierit i fundit i llojit të vet. Rasti më i njohur i tentativës për rikthimin e prodhimit termik është ai i dy termocentraleve lundruese ("Tigri 1" dhe "Tigri 3") me kontratë rreth 336 milionë eurosh dhe kosto ditore 94.000 euro/ditë që mbetën pa prodhuar energji për mbi një vit për shkak të vonesave në licencim nga ERE. Ky rast nënvizon qartë se rikthimi të kapacitetet termike nuk konsiderohet nga qeveria si zgjidhje strategjike afatgjatë, por si masë emergjente e kalimtare.

Shqipëria ndodhet sot në një pikë kyçe të historisë së saj, ku procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian po avancon dhe me të vijnë edhe detyrimet për të harmonizuar kuadrin ligjor dhe klimatik me atë të BE-së. Ky kontekst e bën çdo investim të ri në termocentrale jo vetëm ekonomikisht të dyshimtë, por edhe strategjikisht të papajtueshëm me rrugëtimin evropian të vendit për disa arsye:



- Në prag të anëtarësimit, një kapacitet i ri termik do të hynte në një mjedis rregullator që favorizon dekarbonizimin, eficiencën dhe burimet e rinovueshme. RED III vendos një objektiv të detyrueshëm prej të paktën 42,5% energji të rinovueshme në konsumin final të BE-së deri në 2030, ndërsa Shqipëria ka tashmë një miks elektrik shumë më të gjelbër. Kjo e rrit rrezikun që një TEC i ri me jetë ekonomike 30–40 vjet të përballet me kosto karboni, standarde më të forta mjedisore dhe përdorim gjithnjë e më të ulët pas integritimit në tregun evropian.
- Shqipëria disponon burime hidrike të konsiderueshme, rrezatim diellor rreth 1,185–1,700 kWh/m²/vit dhe potencial të rëndësishëm eolik. Në këtë kontekst, çdo euro e angazhuar në një TEC duhet krahasuar me alternativën, kapacitete diellore/eolike, ruajtje me bateri ose pompim, përforsim rrjeti dhe interkoneksione. Këto investime jo vetëm prodhojnë energji pa karburant të importuar, por ulin edhe ekspozimin ndaj çmimeve ndërkombëtare të gazit dhe naftës.
- Roli i mundshëm i termocentraleve duhet kufizuar te siguria dhe fleksibiliteti, jo te prodhimi bazë. Një kapacitet termik mund të ketë vlerë si rezervë emergjente në skenarë ekstremë, por ndërtimi i TEC-eve të reja për prodhim të vazhdueshëm është më pak koherent me profilin natyror të vendit dhe me drejtimin e politikës evropiane. Alternativa më strategjike është kombinimi hidro–diell–erë me ruajtje dhe tregti rajonale, ku hidrocentralet shërbejnë si burim fleksibël që balancon variabilitetin e diellit dhe erës.
- Në terma kosto-përfitim, krahasimi duhet bërë mbi koston e plotë të sistemit dhe jo vetëm mbi çmimin e ndërtimit. Një TEC kërkon investim fillestar, karburant të importuar gjatë gjithë jetës së tij, mirëmbajtje, kosto të emetimeve dhe ekspozim ndaj çmimeve të karbonit, ku përfitimi kryesor është prodhimi i komandueshëm. Një park fotovoltaik ose eolik ka prodhim variabël dhe kërkon fleksibilitet/ruajtje, por nuk ka kosto karburanti dhe ka kosto operative më të ulët. Çmimet shumë konkurruese të arritura në ankandet shqiptare të energjisë diellore tregojnë se, për energjinë bazë të re, burimet e rinovueshme kanë avantazh ekonomik, fondet publike do të krijojnë vlerë më të madhe në rrjet, ruajtje dhe rezervë sesa në një varësi të re afatgjatë nga lëndët djegëse.




Tabela 2. Evoluimi i rolit të termocentraleve në sistemin shqiptar

Periudha	Ngjarja kryesore	Efekti në miks
1951–1990	Ndërtimi i 7 TEC-eve (194 Mw)	Baza fillestare e elektrifikimit
1991–2007	Mbyllja graduale e TEC-ve (Vlorë Fier)	Rënie drastike e prodhimit termik
2022–sot	TEC-e lundruese me qira në Vlorë (114 Mw)	Rezervë emergjence
2025–2026	Roli termik mbetet nën 2–3% e prodhimit total	Miksi mbetet i dominuar nga hidro


Burimi: UET Economicus

5 ENERGJIA DIELLORE ANKANDET, SUBVENCIONET DHE RRTJJA E KAPACITETIT

Energjia diellore përfaqëson zhvillimin më dinamik të tranzicionit energjetik shqiptar në dekadën e fundit. Pika e kthesës ishte ankandi ndërkombëtar i korrikut 2024 për parkun fotovoltaik hibrid me kapacitet 300 megavat, ku morën pjesë 14 kompani të huaja dhe ku u arrit një çmim prej vetëm 24,89 euro/MWh për parkun e Karavastasë një nga çmimet më të ulëta të arritura ndonjëherë në Evropë për energji diellore. Parku i Karavastasë (140 MW prodhim vjetor) është në funksion që nga shkurti 2024, ndërsa parku i Spitallës në Durrës vijon të ndërtohet. Në ankandin paralel për energjinë e erës, vendi përfitoi rreth 222,5 MW kapacitete të reja eolike.

Sipas të dhënave më të fundit të raportuara nga ERE (Enti Rregullator i Energjisë) për vitin 2025, kapaciteti fotovoltaik i instaluar në Shqipëri arriti në 631 MW, ndërsa prodhimi diellor përfaqësoi rreth 11% të prodhimit total vendas të energjisë elektrike, nga vetëm 6,4% një vit më parë. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ka konfirmuar publikisht se, në disa ditë dhe orare të caktuara, kaskada e Drinit “pushon” prodhimin për t’ia lënë vendin energjisë diellore, e cila tashmë mbulon vetë nevojat në ato orë. Kjo është evidenca më e fortë empirike e efektivitetit të politikës diversifikuese deri më sot, ku brenda dy vitesh, energjia diellore ka kaluar nga një burim thuajse simbolik (rreth 1% e prodhimit në 2022) në një komponent operacional të rëndësishëm të sistemit. Ky rezultat përbën një nga gjetjet kryesore empirike të raportit.

Përtej impianteve të mëdha, qeveria ka nisur dy faza të një skeme subvencionimi prej 70% të kostove për familjet që instalojnë panele diellore fotovoltaike ose për ngrohjen e ujit sanitar. Faza e parë (2024) përfshiu 2 000 familje, ndërsa faza e dytë (hapur në shkurt 2025, sipas VKM nr. 733, datë 27.11.2024) synoi po ashtu 2 000 familje shtesë, duke sjellë kursime mujore të vlerësuar nga 2 000 deri në 4 000 lekë për familje. Aplikimet menaxhohen nga Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE) përmes portalit panelet.eficenca.gov.al. Duke filluar nga viti 2026, legjislacioni i ri i harmonizuar me kërkesat e Bashkimit Evropian për performancën energjetike të ndërtesave e




bën të detyrueshme instalimin e teknologjive diellore në të gjitha ndërtesat e reja, në përputhje me nivelin e rrezatimit diellor të zonës.

Vlerësimi kritik i skemës së subvencioneve tregon një efektivitet të kufizuar në shkallë, ku 4 000 familjet e përfituara në dy faza (deri në fillim të vitit 2025) përfaqësojnë vetëm rreth 0,5% të rreth 759 000 familjeve të numëruara nga INSTAT (2022), pra një masë e vogël për të dhënë efekt sistematik. Ky konstatim nuk duhet lexuar si argument kundër mbështetjes publike si e tillë, duke qenë se sektori i vetëkonsumit diellor nis praktikisht nga zero, politikat mbështetëse janë të justifikuara, por masa e përfituesve duhet të jetë dukshëm më e madhe. Alternativat që mund ta zgjerojnë ndikimin pa rritur në mënyrë të pakontrolluar barrën fiskale përfshijnë: (i) kontratat për diferencë (CfD) dhe ankandet konkurruese, të cilat kanë sjellë tashmë çmimet më të ulëta të energjisë diellore në Evropë (24,89 €/MWh në Karavasta); (ii) skemat e matjes neto (net-metering) me bilanc vjetor, që ulin barrierën fillestare për familjet; (iii) modelet e leasing-ut ose të pronësisë së tretë për panelet, që zhvendosin koston e investimit nga familja te operatori; dhe (iv) synimi i familjeve me të ardhura të ulëta e i zonave rurale me rrjet të dobët, si instrument i drejtësisë energjetike. Veçanërisht e rëndësishme është lidhja e skemës me shfrytëzimin e tokave djerrë e të degraduara, për të cilat është diskutuar në Kuvend një nismë që lejon vendosjen e paneleve në toka të tilla pa cënuar tokën prodhuese (shih kapitullin mbi agrofotovoltaikët). Ndërkohë, impakti kryesor të miksi energjetik vjen jo nga panelet e vogla individuale, por nga ankandet e mëdha industriale (Karavasta, Spitalla dhe projektet e reja prej 118,5 MW në Fier e Lushnjë, aplikuar në korrik 2026), të cilat nuk përfitojnë nga masat mbështetëse dhe zhvillohen plotësisht në tregun e lirë. Kjo tregon se motori kryesor i tranzicionit diellor në Shqipëri është konkurrenca e tregut (çmimet konkurruese të arritura në ankande) dhe jo domosdoshmërisht subvencionin publik, i cili luan më shumë rol social e simbolik sesa strukturor.

6

ENERGJIA E ERËS DHE PROJEKTET E NDËRLIDHJES RAJONALE

Energjia e erës mbetet burimi më pak i zhvilluar në miksin shqiptar, me vetëm rreth 37 MW të miratuara dhe 49 MW në fazë para-miratimi më 2023, por me një potencial të vlerësuar deri në 2,500 MW brenda 2030-s, veçanërisht në zonat verilindore të vendit (Ekofin, 2026). Zhvillimi i energjisë së erës është i lidhur ngushtë me projektet e infrastrukturës transmetuese veçanërisht interkoneksionin e ri me Kosovën pasi pa kapacitet të mjaftueshëm rrjeti, energjia e prodhuar nga era në verilindje të vendit nuk mund të shkarkohet në mënyrë të qëndrueshme drejt qendrave kryesore të konsumit.




7 ZHVILLIMET E REJA NË KAPACITETET PRODHUESE, HIDROCENTRALET E REJA TË LICENCUARA

Sipas të dhënave të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), përveç mbi 140 hidrocentraleve të vogla ekzistuese, në proces ndërtimi apo licencimi ndodhen edhe 10 hidrocentrale të reja me kapacitet të kombinuar prej 458 MW, që pritet të rrisin prodhimin total kombëtar të energjisë me rreth 31%. Megjithatë, vërtetuesit e sektorit vërejnë se ritmi i licencimeve të reja ka ngadalësuar krahasuar me “valën” e dytë të revolucionit hidroenergjetik (2010–2020), kur u licencuan me qindra hidrocentrale të vogla, disa prej të cilave brenda zonave të mbrojtura mjedisore. Rruga që Shqipëria po zgjedh për të rritur potencialin energjetik po zhvendoset pikërisht nga ky model i intervenimit të gjerë e pakontrolluar drejt një modeli më të kontrolluar, në të cilin zhvillimi i kapaciteteve në zona me vlera natyrore kërkon konsensusin e banorëve dhe miratime të qarta institucionale. Çdo cënim i zonës së mbrojtur duhet të ketë një përfitim të matshëm energjetik për vendin dhe një përlllogaritje të saktë të ndikimit ekonomik që ai do prodhojë. Prandaj, për çdo projekt në zona të tilla duhet llogaritur në mënyrë transparente se sa energji, siguri furnizimi dhe ulje importesh sjell në fakt dhe nëse ky përfitim justifikon ndikimin mjedisor. Qeveritë duhet të jenë më transparente mbi përfitimet e projekteve në këto zona, duke publikuar studimet e vlerësimit, kontratat dhe treguesit e pritshëm, në mënyrë që debati publik të bazohet në fakte. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka theksuar se prioriteti aktual nuk është më zgjerimi i pakontrolluar i HEC-eve të vogla, por diversifikimi drejt burimeve jo-hidrike orientim që përkon me këtë logjikë të përfitimit të matshëm.

Projekti më ambicioz afatgjatë mbetet zgjerimi i hidrocentralit me pompim në Moglicë (pjesë e projektit të Devollit, operuar nga kompania norvegjeze Statkraft), i përfshirë në listën e Projekteve me Interes të Komunitetit të Energjisë (PECI) 2026 të Bashkimit Evropian, me një kapacitet të planifikuar deri në 1,620 MW dhe kapacitet ruajtjeje prej rreth 30 GWh që do ta bënte një nga “bateritë” më të mëdha energjetike të Ballkanit Perëndimor, të aftë të ruajë tepricat e prodhimit diellor dhe t'i kthejë në rrjet në orët e kërkesës së lartë. Në të njëjtën listë përfshihen edhe ndërtimi i një linje të re 400 kV me Kosovën (Fierzë–Prizren) dhe rehabilitimi i linjës 220 kV Trebinjë–Peruçicë–Podgoricë–Vau i Dejës, që synojnë të përgatisin rrjetin transmetues për integrimin e mbi 1 GW kapacitete të reja të erës.

8 PARADOKSI DIELLOR, POTENCIAL I LARTË DHE VARËSIA NGA HIDROKARBURET

Shqipëria gëzon një nga potencialet më të larta diellore në Evropë. Vlerësimet akademike tregojnë një mesatare prej mbi 300 ditësh me diell në vit, ose mbi 2,400 orë rrezatimi diellor, me zona si Fieri që regjistrojnë deri në



2,815 orë diell në vit rreth 20–30% më shumë rrezatim se vendet e tjera të rajonit, si Maqedonia e Veriut apo Kosova. Megjithatë, deri pak vite më parë, ky potencial mbetej pothuajse tërësisht i pashfrytëzuar. Sipas Zërit të Amerikës, Shqipëria prodhonte atëherë vetëm rreth 1% të energjisë së saj nga dielli, kryesisht për shkak të procedurave burokratike dhe mungesës së liberalizimit të plotë të tregut.


Ky është “paradoksi diellor” qëndror i studimit, një vend me kushte natyrore më të mira se shumica e fqinjëve evropianë ka mbetur, deri kohët e fundit, dukshëm prapa në shfrytëzimin e tyre. Shpjegimi qëndron te kombinimi i tri faktorëve strukturorë: (i) investimet historike kanë qenë të përqendruara pothuajse ekskluzivisht te hidroenergjinë, e cila kërkonte më pak risi rregullatore për kohën kur u zhvillua; (ii) mungesa e kuadrit ligjor për vetëprodhimin dhe injektimin në rrjet të energjisë diellore deri në reformat e viteve 2021–2023; dhe (iii) kostoja fillestare relativisht e lartë e teknologjisë fotovoltaike krahasuar me të ardhurat mesatare familjare, e cila e ka bërë investimin individual të varur nga subvencionet shtetërore.

9 PSE SHQIPËRIA ENDE VARET NGA IMPORTI DHE HIDROKARBURET?

Pavarësisht rritjes së shpejtë të energjisë diellore, Shqipëria mbetet e ekspozuar ndaj hidrokarbureve në disa nivele. Së pari, importi i energjisë elektrike i domosdoshëm në vitet e thata shpesh vjen nga vende me miks energjetik të bazuar te gazi natyror dhe qymyri, duke transferuar në mënyrë indirekte varësinë nga hidrokarburet përtej kufijve kombëtarë. Pesha e importeve në raport me nevojat vendase u rrit nga 24.4% në vitin 2023 në 32.7% në vitin 2024, me një kosto totale importesh (përfshirë TVSH-në) prej rreth 100 milionë eurosh, nga 70 milionë euro në 2023.


Së dyti, sektori i transportit që përbën pjesën më të madhe të konsumit final të energjisë në Shqipëri mbetet thuajse tërësisht i varur nga karburantet fosile (naftë dhe benzinë), pasi elektrifikimi i automjeteve është ende në fazat e para. Raporti i Agjencisë Evropiane të Mjedisit vë në dukje se, ndonëse Shqipëria shënon rezultate rekord në energjinë e rinovueshme për prodhimin elektrik, ajo “çalon” ndjeshëm te dekarbonizimi i transportit. Kjo është arsyeja themelore pse pjesa e energjisë së rinovueshme në konsumin final total të energjisë (që përfshin ngrohjen dhe transportin, jo vetëm prodhimin elektrik) mbetet dukshëm më e ulët se pjesa e saj vetëm në prodhimin elektrik, objektivi kombëtar për 2030 sipas Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës është që deri në 54.4% e konsumit final total të vijë nga burimet e rinovueshme.

Së treti, humbjet në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes mbeten një pengesë strukturore serioze për efektivitetin real të çdo investimi në prodhim të pastër. Eenergjinë e prodhuar pa emetime karboni humbet pjesërisht



rrugës drejt konsumatorit final. Humbjet janë ulur ndjeshëm në një dekadë, nga rreth 45% në më pak se 19%, por kjo shifër mbetet ende rreth 2,4 herë mbi standardin mesatar të vendeve të BE-së (nën 8%) një gjetje strukturore kyçe e këtij raporti duke nënkuptuar që një pjesë e konsiderueshme e energjisë “së gjelbër” thjesht humbet përpara se të përdoret, gjë që rrit tërthorazi nevojën për import shtesë (FIP Dashboard Energjia, 2026).

Grafiku 1. Evolucion i humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin elektrik shqiptar




Burimi: FIP, (FIP Dashboard Energjia, 2026)

10 ELEKTRIFIKIMI I TRANSPORTIT RRUGOR

Sipas INSTAT, në fund të vitit 2025 në Shqipëri ishin të regjistruara 1,048,000 mjete me status aktiv, duke shënuar një rritje me 9,3% krahasuar me vitin paraardhës, ku autoveturat përbënin 81% të totalit, me një raport 361 autovetura për 1 000 banorë (nga 326 në 2024). Tirana mban peshën kryesore me 35% të parkut kombëtar, e ndjekur nga Durrësi (14%) dhe Fieri (9%). Ndonëse nafta mbetet karburanti dominant, duke furnizuar ende 72% të autoveturave, numri i autoveturave elektrike u rrit me 91% në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024, shifra më e lartë e rritjes vjetore e regjistruar deri më sot për këtë kategori.

Të dhënat më të fundit të DPSHTRR tregojnë përshejtim edhe më të theksuar në shtatë muajt e parë të vitit 2026 u regjistruan për herë të parë mbi 6 mijë mjete tërësisht elektrike, ose rreth 12% e totalit të regjistrimeve të reja, pra një rritje prej 126% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2025-ës. Gjeografia e importeve po ndryshon ngjashëm, ku Koreja e Jugut mban vendin e parë (25,5% e regjistrimeve në janar–korrik 2026), ndërsa Kina ka kapërcyer Gjermaninë dhe Italinë, duke u ngjitur në vendin e dytë me 16% të totalit, rritje e lidhur drejtpërdrejt me orientimin drejt automjeteve elektrike më ekonomike nga tregu kinez.



10.1 Analizë krahasuese e kostos, makinë me naftë kundrejt makinës elektrike

Rritja e shpejtë e regjistrimeve elektrike, sidomos nga tregu kinez, shpjegohet kryesisht me faktorin ekonomik, automjetet elektrike të importuara nga Kina ofrohen shpesh me çmime më të ulëta se ekuivalentët evropianë, ndërkohë që kostoja operative afatgjatë favorizon makinat elektrike.

Sipas vendimit nr. 255, datë 15.10.2025, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) miratoi çmimin e ri të shitjes së energjisë elektrike për pikat/stacionet e karikimit të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11 kW, duke e rritur atë nga 14 lekë/kWh në 22 lekë/kWh (tarifa normale) dhe në 25.3 lekë/kWh (orari i pikut), e cila llogaritet si +15% mbi çmimin normal.

Tabela 3. Ndryshimi i tarifave të energjisë elektrike për karikimin e automjeteve elektrike (Lekë/kWh)

Kategoria	Çmimi para vendimit (Lekë/kWh)	Çmimi pas vendimit (Lekë/ kWh)
Pika/stacione karikimi EV, fuqi instaluar >11 kW, tarifa normale	14	22
E njëjta kategori gjatë orarit të pikut (18:00–22:00)	14	25.3
Karikimi në shtëpi (tarifa familjare, pa TVSH)	9.5	8.5 (≤ 700 kWh/ muaj) ose 9.5 (> 700 kWh/ muaj)


Burimi: ERE

Për të krahasuar koston e përdorimit të një automjeti me naftë me atë të një automjeti elektrik, është e rëndësishme të merren në konsideratë çmimet përfaqësuese të karburanteve dhe të energjisë elektrike në Shqipëri. Sipas GlobalPetrolPrices dhe monitorimeve të tregut shqiptar gjatë viteve 2025–2026, çmimi i naftës është luhatur ndërmjet rreth 198 dhe 219 lekë për litër. Duke qenë se niveli prej 219 lekë/litër lidhet me një periudhë të veçantë të rritjes së çmimeve, për këtë analizë është përdorur një çmim mesatar prej 205 lekë/litër, ndërsa për benzinën është marrë si referencë çmimi prej rreth 170 lekë/litër.

Analiza bazohet në supozimin se një automjet me naftë konsumon mesatarisht 6 litra për 100 km, ndërsa një automjet elektrik 18 kWh për 100 km. Për të dyja rastet është marrë një kilometrazh mesatar prej 15,000 km në vit.

Me këto supozime, një automjet me naftë konsumon rreth 900 litra në vit. Me një çmim mesatar prej 205 lekë/litër, kostoja vjetore e karburantit arrin në rreth 184,500 lekë, ose afërsisht 1,939 euro.

Për të njëjtin kilometrazh, automjeti elektrik konsumon rreth 2,700 kWh energji elektrike në vit. Megjithatë, siç paraqitet edhe në Tabelën 4, kostoja përfundimtare ndryshon ndjeshëm në varësi të vendit dhe orarit ku kryhet karikimi.



Nëse automjeti karikohet në shtëpi, me tarifën familjare prej 9.5 lekë/kWh, kostoja vjetore e energjisë elektrike rezulton rreth 25,650 lekë, ose afërsisht 270 euro.

Nëse karikimi kryhet në një stacion publik ku aplikohet tarifa normale prej 22 lekë/kWh, kostoja vjetore rritet në 59,400 lekë, ose rreth 624 euro. Kjo përfaqëson një kosto rreth 131.6% më të lartë krahasuar me karikimin në shtëpi.

Në skenarin e tretë, kur automjeti karikohet në një stacion gjatë orarit të pikut, me tarifën 25.3 lekë/kWh, kostoja vjetore arrin në 68,310 lekë, ose rreth 718 euro, duke qenë rreth 166% më e lartë se kostoja e karikimit në shtëpi.


Siç evidentohet në Tabelën 4, diferenca ndërmjet tre skenarëve të karikimit është e konsiderueshme. Karikimi në shtëpi mbetet alternativa me koston më të ulët, ndërsa përdorimi i stacioneve publike, veçanërisht gjatë orarit të pikut, e rrit ndjeshëm faturën vjetore të energjisë.


Megjithatë, edhe në skenarin me tarifën më të lartë të karikimit, kostoja vjetore e energjisë elektrike mbetet dukshëm më e ulët se kostoja vjetore e karburantit për automjetin me naftë. Për 15,000 km në vit, krahasimi është 1,939 euro për automjetin me naftë, kundrejt 270–718 euro për automjetin elektrik, në varësi të mënyrës së karikimit. Kjo do të thotë se, krahasuar me një automjet me naftë, kostoja vjetore e energjisë për një automjet elektrik është rreth 86% më e ulët kur karikohet në shtëpi, 68% më e ulët kur karikohet në stacion me tarifën normale dhe 63% më e ulët kur karikohet në stacion gjatë orarit të pikut.

Tabela 4. Skenarët e koston së karikimit të një makine elektrike

Skenari i karikimit	Tarifa lekë /kWh	Kosto vjetore lekë /vit	Ndryshimi kundrejt karikimit në shtëpi (9.5)
A. Në shtëpi (tarifa familjare >700 kWh/ muaj)	9,5	2 70 euro	0
B. Në stacion, aplikohet tarifa normale	22,0	624 euro	↑ 131,6%
C. Në stacion, aplikohet tarifa për orarin e pikut (18:00–22:00)	25,3	718 euro	↑ 166%

Burimi: Përpunim i autorit



Grafiku 2. Diferencat në kosto mes një makine me naftë dhe një makine elektrike për 1 vit


Burimi: Përpunim i autorit

Ky krahasim tregon se, edhe pse kostoja fillestare e blerjes së një automjeti elektrik të ri (veçanërisht jo-kinez) mbetet shpesh më e lartë se ajo e një automjeti me naftë të përdorur, kursimet vjetore operative në karburant/energji, mirëmbajtje dhe taksë vjetore mund të arrijnë deri në 63–86% krahasuar me një automjet me naftë. Ky bilanc kosto-përfitim afatgjatë, i kombinuar me çmimet gjithnjë e më konkurruese të modeleve kineze, shpjegon në mënyrë të drejtpërdrejtë përse rritja e regjistrimeve elektrike po përshpejtohet aq shpejt, pavarësisht mungesës ende të një rrjeti kombëtar të plotë stacionesh karikimi (shih seksionin e infrastrukturës së karikimit më poshtë).

Në aspektin makro, elektrifikimi i transportit ka edhe një përfitim të drejtpërdrejtë për politikën energjetike, çdo automjet elektrik shtesë e zhvendos kërkesën për energji nga hidrokarburet e importuara drejt rrjetit vendas elektrik, i cili siç u analizua në kapitujt e mëparshëm po bëhet gjithnjë e më i pastër falë rritjes së energjisë diellore. Pra, sa më i pastër rrjeti elektrik, aq më i madh përfitimi mjedisor i çdo automjeti të ri elektrik të regjistruar.

10.1 Infrastruktura e Karikimit

Qeveria shqiptare kishte planifikuar vendosjen e 200–300 stacioneve të karikimit në të gjithë vendin deri në vitin 2025, me një buxhet të vlerësuar prej 5,4 milionë dollarësh (afërsisht 5 milionë €), sipas NECP (National Energy and Climate Plan). Ky plan përfshin tenderin për pikat e karikimit të automjeteve elektrike në të gjithë vendin. Të dhënat e disponueshme tregojnë se zbatimi ka ecur më ngadalë se plani, ku për vitin 2023 raportohen rreth 26 pika të reja karikimi (përfshirë 2 pika me fuqi 250 kW në Durrës dhe kontrata me fuqi të instaluar rreth 2 565 kW në Tiranë), ndërsa një regjistër i plotë kombëtar publik nuk është ende i disponueshëm. Por, numrin dhe gjendjen e stacioneve aktive mund t'i shohë kushdo në kohë reale përmes aplikacioneve online dhe hartave digjitale të dedikuara (p.sh. PlugShare, Google Maps dhe platformat e operatorëve privatë si iCharge), të cilat tregojnë vendndodhjen, fuqinë dhe disponueshmërinë e pikave një burim i dobishëm informacioni për përdoruesit dhe për monitorimin e politikave. Sipas njoftimit të DPSHTRR-së, për herë të parë për automjetet elektrike tarifa




e regjistrimit është zero; për më tepër, automjetet elektrike dhe hibride kanë qenë të përjashtuara nga taksat e regjistrimit dhe taksa vjetore e qarkullimit deri në gusht 2026.

11 TRANSPORTI URBAN, ELEKTRIFIKIMI DHE MOBILITETI I QËNDRUESHËM

Elektrifikimi i automjeteve ul varësinë nga karburantet fosile, por nuk zgjidh i vetëm problemet e transportit urban. Evidenca e përmbledhur për Tiranën dhe qytete të tjera tregon se trafiku rrugor lidhet ngushtë me përqendrimet e PM2.5, PM10 dhe NO2, veçanërisht në akset dhe kryqëzimet me fluks të lartë. Prandaj politika e transportit duhet të kombinojë automjetet elektrike me transport publik cilësor, ecje, biçikleta, menaxhim parkimi dhe planifikim urban që redukton nevojën për përdorimin e makinës private. Kjo qasje e zhvendos objektivin nga "zëvendësimi i motorit" drejt uljes së emetimeve, konsumit të energjisë dhe ekspozimit të popullsisë ndaj ndotjes. Elektrifikimi redukton konsumin e karburanteve dhe emetimet nga motori, por politika urbane mbetet e paplotë nëse numri i automjeteve private dhe ngarkesa e trafikut vazhdojnë të rriten. Në këtë drejtim, DPSHTRR ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm institucional, ku ka ngritur një databazë/dashboard zyrtar statistikor të regjistrimeve të mjeteve elektrike në Shqipëri, i aksesueshëm online, i cili mundëson monitorimin e flotës kombëtare dhe mbulimin e përdorimit nga institucionet publike, një bazë e mirë për politikën e dekarbonizimit të flotës shtetërore. Prandaj, objektivi duhet të jetë njëkohësisht dekarbonizimi i flotës dhe zhvendosja e një pjese të lëvizjeve drejt transportit publik, ecjes dhe biçikletës, veçanërisht në zonat me ekspozim të lartë ndaj ndotjes.

12 KRAHASIMI RAJONAL DHE EVROPIAN

Në kontekstin evropian, sipas Agjencisë për Eficencën e Energjisë, Shqipëria renditet e treta pas vendeve skandinave për peshën e energjisë së rinovueshme në konsum në raport me totalin. Për krahasim, Bashkimi Evropian arriti mesatarisht 24,5% të konsumit total të energjisë nga burime të rinovueshme në 2023, me Suedinë në krye me 66,4%. Objektivi i ri i BE-së për 2030 është ngritur nga 32% në 42,5% (me synim deri 45%), duke kërkuar nga vendet anëtare rritje prej pothuajse 20 pikë përqindjeje. Krahasuar me këtë objektiv evropian, ambicia shqiptare (54%) është relativisht e lartë për prodhimin elektrik, por, siç u vu në dukje në kapitujt e mëparshëm, vendi mbetet dukshëm prapa standardeve evropiane në dy tregues plotësues kritikë, dekarbonizimi i transportit dhe humbjet e rrejtë, të cilat, nëse nuk adresohen, mund të zbehin efektin real të arritjeve në prodhim. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria konsiderohet e favorizuar në raport me




fajinjtë për shkak të rrezatimit diellor më të lartë (20–30% më shumë se Maqedonia e Veriut apo Kosova) dhe të bazës hidrike ekzistuese, por edhe ndër vendet me çmimet më të larta rajonale të energjisë për konsumatorët, pikërisht për shkak të varësisë nga importi në periudhat e thatësirës (ACP.al; Monitor.al, 2025). Ky kontrast përbën një gjetje të rëndësishme të krahasimit rajonal, një vend i pasur me burime të gjelbra mund të ketë njëkohësisht çmime të larta për konsumatorët, kur mungojnë investimet paralele në diversifikim, ruajtje energjie dhe infrastrukturë transmetimi pasuria natyrore, në vetvete, nuk garanton siguri apo përballueshmëri energjetike.

Një dallim i rëndësishëm me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor është struktura e prodhimit, ndërsa Shqipëria prodhon pothuajse të gjithë energjinë elektrike nga burime të rinovueshme, në disa sisteme të rajonit qymyri vijon të mbajë peshë të lartë. Ky avantazh mjedisor nuk duhet ngatërruar me sigurinë energjetike. Varësia e Shqipërisë nga hidrocentralet e bën prodhimin të ndjeshëm ndaj thatësirave dhe mund të rikthejë nevojën për importe pikërisht në periudhat me prurje të ulëta. Prandaj, krahasimi rajonal e përforcon nevojën që Shqipëria të kalojë nga një miks “i pastër, por i përqendruar” drejt një miksimi më të balancuar hidro–diell–erë.

Shqipëria gjendet në një moment kyç transformimi energjetik ku potenciali i saj strukturor është i pamohueshëm, por vulnerabiliteti sistematik është po aq i rëndë sa avantazhet e trashëguara. Baza hidrike, që operon deri në 98% të kapacitetit, përfaqëson një avantazh konkurrues evropian, por njëkohësisht zbulon një paradoks të rrezikshëm, një sistem i mbingarkuar ka pak mundësi për të reaguar dhe çdo thatësi mbi mesataren kthehet automatikisht në krizë furnizimi. Kjo varësi nga reshjet nuk është thjesht dobësi teknike është risk sistematik ekzogjen që nuk mund të neutralizohet pa një diversifikim real dhe të planifikuar të miksit energjetik.

Pikërisht këtu hyn rëndësia e rrezatimit diellor shqiptar, me mbi 300 ditë diell në vit, i cili e pozicionon vendin ndër të parët e kontinentit për potencial fotovoltaik. Çmimi prej 24,89 €/MWh i arritur tashmë në ankande konfirmon se tregu e ka njohur këtë realitet, dhe rritja e regjistrimeve të mjeteve elektrike me 126% (janar–korrik 2026, DPSHTRR) sinjalizon ndryshim autentik sjelljesh konsumatore, të pavarur nga politikat publike. Megjithatë, këto dy sinjale pozitive mbeten të brishtë pa infrastrukturën mbështetëse, ku elektrifikimi i transportit nën 15% të regjistrimeve të reja, në mungesë të tarifave të diferencuara dhe të rrjetit të ngarkimit, rrezikon të qëndrojë fenomen urban i klasës së mesme, ndërsa 4 000 familjet e mbështetura me subvencione janë numër simbolik rreth 0,5% e familjeve shqiptare që zbulon mungesën e një politike sociale energjetike me shtrirje reale.

Mbi të gjitha, humbjet në rrjet, të cilat janë 2,4 herë mbi standardin e Bashkimit Evropian, tregojnë një problem të vazhdueshëm ekonomik. Kjo do të thotë se një pjesë e energjisë humbet para se të arrijë te konsumatori dhe, për këtë arsye, investimet në kapacitetet e reja prodhuese japin rendiment



real të reduktuar derisa ky deficit nuk adresohet. Këto probleme kanë vështirësuar zhvillimin e projekteve të reja energjetike, kanë larguar investitorë dhe kanë sjellë kosto shtesë për sistemin. Rasti i TEC-eve lundruese është simptomë, jo anomali.


Projekti i Moglicës me 1,620 MW dhe 30 GWh ruajtje nuk është thjesht kapacitet prodhues shtesë është kalimi i Shqipërisë nga konsumatore hidrike në "bateri" rajonale nëpërmjet teknologjisë së pompimit, gjë që do të ndryshonte thelbësisht pozicionin e saj gjeopolitik energjetik. Interkoneksioni me Kosovën dhe integrimi rajonal nëpërmjet PECl hapin mundësi balancare dhe tregtare që reduktojnë koston e rezervave. Ndërsa potenciali eolian deri në 2,500 MW, shpesh i nënvlerësuar, ka profilin komplementar me PV-në pikërisht sepse prodhon gjatë dimrit dhe natës, kur dielli mungon duke reduktuar organikisht nevojën për ruajtje shtesë.

Rreziqet, megjithatë, nuk janë hipotetike. Ndryshimet klimatike, me parashikime të IPCC-së për rënie 10–20% të prurjeve ujore në Ballkanin Perëndimor deri në 2050, e rëndojnë pikërisht dobësinë qendrore të sistemit dhe e bëjnë diversifikimin jo opion strategjik, por domosdoshmëri të mbijetesës. Varësia e mbetur nga tregjet ndërkombëtare të importit ruan ekspozimin ndaj goditjeve të çmimeve, ndërsa presioni mbi tokën bujqësore nga zgjerimi i shpejtë i PV dhe pabarazia rajonale në përfitim ngrenë çështje politike e mjedisore që, nëse lihen pa adresuar, mund të prodhojnë rezistencë publike ndaj vetë tranzicionit.

Shqipëria nuk ka mungesë potenciali energjitik, por ka mungesë shpejtësie institucionale dhe diversifikimi të riskut. Kombinimi midis avantazheve hidrike e diellore dhe mundësive të Moglicës dhe integritit rajonal është bindës, kombinimi midis varësisë klimatike, humbjeve të rrjetit dhe ngecjes rregullatore është i rrezikshëm po të lihet pa trajtim.

13 ANALIZA SWOT E SISTEMIT ENERGJETIK SHQIPTAR

Analiza SWOT e sistemit energjetik shqiptar synon të përmbledhë në mënyrë të strukturuar faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit. Gjetjet e raportit tregojnë se Shqipëria zotëron avantazhe të rëndësishme strukturore, të lidhura veçanërisht me bazën e gjerë hidroenergjetike, potencialin e lartë diellor, ritjen e shpejtë të kapaciteteve fotovoltaike dhe zgjerimin e rolit të investimeve private. Megjithatë, këto avantazhe shoqërohen me dobësi të dukshme, si varësia e lartë nga kushtet hidrologjike, zhvillimi ende i kufizuar i energjisë së erës, humbjet relativisht të larta në rrjet, varësia e sektorit të transportit nga karburantet fosile dhe problematikat e evidentuara në koordinimin dhe zbatimin institucional.



Në të njëjtën kohë, tranzicioni energjetik krijon mundësi të konsiderueshme për rritjen e sigurisë dhe diversifikimit të sistemit, përmes zhvillimit të energjisë diellore dhe eolike, kapaciteteve të ruajtjes, modernizimit të rrjetit, interkoneksioneve rajonale dhe elektrifikimit gradual të transportit. Përballë këtyre mundësive qëndrojnë edhe rreziqe të rëndësishme, ndër të cilat ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tyre mbi prurjet ujore, ekspozimi ndaj importeve dhe çmimeve të tregjeve ndërkombëtare, vonesat rregullatore, presioni mbi përdorimin e tokës dhe nevoja për përshtatjen e infrastrukturës me kapacitetet e reja prodhuese. Në këtë kuptim, analiza SWOT e paraqitur më poshtë shërben si një sintezë e gjetjeve kryesore të raportit dhe evidenton fushat ku politika energjetike duhet të konsolidojë avantazhet ekzistuese, të adresojë dobësitë dhe të menaxhojë në mënyrë më të kujdesshme rreziqet e tranzicionit.

PIKAT E FORTA

- Bazë hidrike e madhe ekzistuese (deri në 98% e kapacitetit)
- Rrezatim diellor mbi mesataren evropiane (300+ ditë/vit)
- Çmime shumë konkurruese të arritura në ankande (24,89 €/MWh)
- Rritje e shpejtë e regjistrimeve të automjeteve elektrike (+126% në janar-korrik 2026)

PIKAT E DOBËTA


- Varësi ende e lartë nga reshjet dhe luhatjet hidrike
- Humbje në rrjet 2.4 herë mbi standardin e BE-së
- Elektrifikim embrional i transportit (ende <15% e regjistrimeve të reja)
- Subvencione familjare me shtrirje shumë të kufizuar (4 000 familje)
- Vonesa historike në licencim dhe koordinim institucional

MUNDËSITË

- Projekti i Moglicës (1 620 MW, 30 GWh ruajtje) si "bateri" rajonale
- Interkoneksioni i ri me Kosovën dhe integrimi rajonal (PECI)
- Zgjerimi i mëtejshëm i erës (deri 2 500 MW potencial).
- Rënia e vazhdueshme e çmimit të teknologjisë PV dhe EV
- Financim BE dhe institucione financiare ndërkombëtare

RREZIQET

- Ndryshimet klimatike mund të thellojnë paqëndrueshmërinë hidrike
- Varësia e mbetur nga tregjet ndërkombëtare të energjisë/importit
- Rrezik i "ngecjes" së investimeve në rast vonesash rregullatore
- (rasti TEC lundruese)
- Presion mbi tokën bujqësore/mjedisin nga zgjerimi i shpejtë i PV
- Pabarazi rajonale në përfitimet e elektrifikimit të transportit




14 SEKTORI PRIVAT DHE DINAMIKAT E PRODHIMIT TË ENERGJISË NË VITIN 2026

Një zhvillim që plotëson analizën e diversifikimit është ndryshimi i strukturës së pronësisë së kapaciteteve prodhuese një gjetje tjetër e rëndësishme e raportit. Sipas të dhënave të raportuara në mars 2026, prodhuesit privatë zotërojnë rreth 51% të kapacitetit të instaluar, ndërsa KESH rreth 48,6%. Vetëm gjatë vitit 2024 kapaciteti i instaluar u rrit me rreth 537 MW, duke e çuar totalin në afërsisht 3,21 GW, ku një pjesë e rëndësishme e kësaj rritjeje lidhet me fotovoltaiKET. Ky ndryshim tregon se diversifikimi nuk është më vetëm rezultat i politikave publike dhe ankandëve, por po shndërrohet në një proces të udhëhequr në masë të konsiderueshme nga kapitali privat. Në të njëjtën kohë, rritja e rolit privat shton nevojën për rregullim të qëndrueshëm, transparencë në licencim dhe kapacitete të mjaftueshme rrjeti, në mënyrë që investimet e reja të përkthehen në siguri energjetike dhe jo vetëm në shtim nominal të kapaciteteve. Sipas platformës pozitiv.org, e cila i referohet deklaratave zyrtare të qeverisë (të raportuara edhe nga Monitor.al), investimet e akumuluar private në energjinë e rinovueshme në vitet e fundit vlerësohen në mbi 2 miliardë euro, ndërsa energjia diellore ka arritur rreth 10% të kapacitetit të instaluar. Në planin e politikave publike, ky ndryshim e zhvendos fokusin nga pyetja “kush ndërton kapacitetin” te pyetja “si rregullohet, lidhet në rrjet dhe monitorohet ky kapacitet”, në mënyrë që rritja e kapitalit privat të shoqërohet me konkurrencë, transparencë dhe siguri furnizimi.

Të dhënat e INSTAT për janar–mars 2026 japin një provë të qartë se si kushtet hidrike dhe kapacitetet e reja ndikojnë njëkohësisht në bilancin energjetik. Prodhimi neto vendas arriti 3,647 GWh, 63,2% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2025. Struktura e prodhimit ishte 45,7% nga hidrocentralet publike, 47,3% nga hidrocentralet private dhe koncesionare dhe 7% nga centralet fotovoltaiKE. Paralelisht, importet ranë me 57,4%, në 327 GWh, ndërsa eksportet bruto u rritën me 105,4%, në 1 503 GWh. Këto shifra tregojnë se rritja e prodhimit vendas mund ta përmirësojë ndjeshëm pozicionin tregtar të vendit, por nuk e eliminon rrezikun hidrologjik, sepse një pjesë shumë e madhe e prodhimit vijon të mbetet e lidhur me ujin.

Një element që kërkon vëmendje dhe një gjetje e mëtejshme e këtij tremujori është se, në të njëjtën periudhë, humbjet në rrjet u rritën në 516 GWh, ose 8% më shumë se një vit më parë; humbjet në transmetim u rritën me 31,9% dhe ato në shpërndarje me 5,1%. Kjo e përforcon argumentin e raportit se zgjerimi i prodhimit duhet të shoqërohet me modernizimin e rrjetit. Në të kundërt, një pjesë e përfitimit nga kapacitetet e reja dhe nga kushtet e favorshme të prodhimit humbet përpara se energjia të arrijë te konsumatori final.




15 AGROFOTOVOLTAIKËT DHE TOKAT ME BONITET (PRODHIM) TË ULËT.

Në korrik 2026, Kuvendi miratoi ndryshime në ligjin "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të cilat hapin mundësinë për aktivitete agrofotovoltaike dhe eolike në tokat bujqësore me bonitet të ulët (deri në 8), duke e lënë përcaktimin e kriterëve konkrete të përdorimit në dorë të qeverisë (VKM). Në debatin parlamentar, qeveria i argumentoi ndryshimet si një ndërhyrje të kufizuar e të nevojshme për ta përshtatur kuadrin me bujqësinë moderne, ku teknologjia vihet në funksion të tokës, fermerit dhe prodhimit, duke përmirësuar përdorimin e ujit dhe të lëndëve ushqyese. Nga ana tjetër, deputetë ngritën shqetësimin se kufijtë e lejueshëm duhet të përcaktohen në ligj dhe jo në VKM, për të mos rrezikuar që parqet fotovoltaike të shtrihen më pas në toka të tëra bujqësore.

Përtej debatit, ndryshimi ka anë pozitive të qarta për raportin: (i) e zhvendos debatin nga pyetja "a mund të përdoret toka bujqësore për energji" te pyetja "cilat toka, me çfarë kushtesh dhe me çfarë mbrojtjesh"; (ii) hap rrugën për modele agrofotovoltaike që ruajnë njëkohësisht funksionin bujqësor (bujqësi dhe energji në të njëjtën sipërfaqe), duke rritur të ardhurat e fermerëve dhe prodhimin e decentralizuar; dhe (iii) në terma të furnizimit me energji, i mundëson Shqipërisë të shtojë kapacitetin diellor pa konsumuar tokë bujqësore prodhuese, duke forcuar sigurinë e furnizimit pa rritur konfliktin me sigurinë ushqimore. Politika më e kujdesshme do të ishte që prioritet t'u jepet tokave djerrë, të degraduara, të kripura ose me produktivitet të ulët, çative dhe zonave industriale duke e lidhur këtë kapitull edhe me skemën e subvencioneve familjare, e cila mund të orientohet pikërisht drejt këtyre sipërfaqeve. Kjo ul konfliktin midis sigurisë energjetike dhe sigurisë ushqimore.

16 A MUND TË MBËSHTETET SHQIPËRIA 100% NË ENERGJI TË RINOVUESHME?

Nga pikëpamja e potencialit fizik, përgjigja për sektorin elektrik është po Shqipëria ka burime të mjaftueshme që, në bilanc vjetor, të prodhojë sasinë e energjisë elektrike që konsumon vetëm nga burime të rinovueshme. Vetëm potenciali hidroenergjetik është vlerësuar deri në rreth 16 TWh/vit, ndërsa rrezatimi diellor dhe potenciali i erës shtojnë një rezervë të konsiderueshme të pashfrytëzuar. Për krahasim, në tremujorin e parë të vitit 2026 energjia e disponueshme ishte 2,47 TWh; një ekstrapolim i thjeshtë vjetor do të jepte rreth 9,9 TWh, megjithatë konsumi real ndryshon sipas sezonit. Kjo tregon se kufizimi kryesor nuk është mungesa e energjisë natyrore, por aftësia për ta prodhuar në kohën e duhur, për ta ruajtur dhe për ta transportuar pa humbje. Megjithatë, "100% e rinovueshme" në bilanc vjetor nuk është e njëjtë me furnizim 100% të sigurt në çdo orë, pasi hidroenergjia varet nga




reshjet, dielli nuk prodhon natën dhe bie në dimër, era është e ndryshueshme. Prandaj një sistem plotësisht i rinovueshëm kërkon katër shtylla, të analizuara në kapitujt e mëparshëm: (i) diversifikim real hidro–diell–erë; (ii) ruajtje energjie me pompim dhe bateri; (iii) rrjet i modernizuar me humbje shumë më të ulëta; dhe (iv) interkoneksione e treg rajonal që lejojnë import dhe eksport balancues. Në këtë model, importi nuk është domosdoshmërisht dështim i autonomisë, por instrument fleksibiliteti, për sa kohë që në bilanc vjetor vendi mund të jetë neutral ose eksportues neto.


Për gjithë ekonominë, objektivi 100% i rinovueshëm është më i vështirë se për elektricitetin, sepse transporti dhe një pjesë e ngrohjes vazhdojnë të përdorin produkte naftë. EEA raporton se pjesa e burimeve të rinovueshme në konsumin final bruto arriti 46.6% në 2023, ndërsa NECP i përditësuar synon 59.4% deri në 2030. Kështu, rruga drejt 100% kalon jo vetëm nga ndërtimi i centraleve të reja, por nga elektrifikimi i transportit dhe ngrohjes, efienca energjetike dhe zhvendosja e konsumit drejt orëve kur ka prodhim të bollshëm diellor/eolik.

Nga ana tjetër skenari termik ofron avantazhin e prodhimit të komandueshëm, por krijon kosto të përsëritura për karburant, ekspozim ndaj çmimeve ndërkombëtare dhe karbonit, si dhe rrezik të aktiveve të bllokuara gjatë afrimit me BE-në. Skenari i rinovueshëm kërkon kapital më të madh në fillim për impiante, rrjet dhe ruajtje, por më pas ka kosto shumë më të ulëta karburanti dhe e mban një pjesë më të madhe të vlerës ekonomike brenda vendit. Për Shqipërinë, përfitimi shtesë është komplementariteti i rezervuarëve hidro, të cilët mund të kursejnë ujë në orët me diell dhe të prodhojnë në mbrëmje, ndërsa era mund të plotësojë prodhimin në periudha kur fotovoltaiKET janë më të dobët. Kjo e bën investimin në fleksibilitet sistemik ekonomikisht më të arsyeshëm sesa ndërtimin e një baze të re termike.

Përfundimi analitik është se Shqipëria mund të synojë në mënyrë të besueshme një sistem elektrik praktikisht 100% të rinovueshëm, por jo duke u mbështetur në një burim të vetëm. Kushti është që investimet e viteve 2026–2030 të zhvendosen nga logjika 'më shumë kapacitet prodhues' drejt logjikës 'më shumë kapacitet i menaxhueshëm', ku dielli dhe era të jenë të kombinuara me hidro, ruajtje, rrjet inteligjent dhe integrim rajonal. Termocentralet mund të mbeten rezervë tranzitore ose emergjente, por nuk rezultojnë zgjedhja optimale si shtylla e re e sistemit.



Grafiku 3. Bilanci elektrik në T2 2025 dhe T2 2026




Burimi: INSTAT (2026)

Rruga drejt objektivave të NECP 2030, i cili në versionin e përditësuar synon 59,4% të energjisë nga burime të rinovueshme në konsumin final bruto, kalon nëpër katër drejtime paralele: diversifikim prodhues (diell dhe erë), ruajtje energjie, modernizim të rrjetit dhe elektrifikim të transportit/ngrohjes. Analiza e potencialit tregon se një sistem elektrik praktikisht 100% i rinovueshëm është teknikisht i arritshëm në bilanc vjetor, por siguria orare kërkon fleksibilitet, interkoneksione dhe rezervë. Kjo është arsyeja pse investimi strategjik duhet të orientohej para së gjithash drejt këtyre kapaciteteve dhe jo drejt një baze të re termike afatgjatë.




GJETJET KRYESORE

- 01** Sistemi prodhues mbetet i dominuar nga hidroenergjia (më shumë se 90% e kapacitetit), duke shtuar rrezikun e importeve të shtrenjta në vitet e thata (në 2025, prodhimi i KESH-it ra me 22% kundrejt mesatares 30-vjeçare).
- 02** Pesha e burimit të diellit në prodhimin e energjisë u rrit nga 6,4% në rreth 11% brenda një viti, kapaciteti fotovoltaik u trefishua (140 → 631 MW), ndërsa çmimi i ankandit të Karavastasë (24,89 €/MWh) është ndër më të ulët në Evropë.




- 03** Humbjet në rrjet regjistrohen rreth rreth 2,4 herë mbi standardin e BE-së dhe u rritën në 516 GWh në tremujorin e parë 2026 (+8%), ndërsa humbjet në transmetim u rritën me 31,9%, duke zbehur rendimentin e investimeve të reja prodhuese.
- 04** Transporti i automjeteve vazhdon të mbështetet në pjesën më të madhe të konsumit final tek nafta (72% e autoveturave), pavarësisht rritjes së shpejtë të makinave elektrike në vitet e fundit (+91% në 2025; +126% në janar–korrik 2026).
- 05** Politikat diversifikuese kanë qenë efektive në shkallën e tregut dhe të investimeve private (veçanërisht në energjinë diellore), por ende jo të mjaftueshme për të eliminuar rrezikun strukturor hidrik ose për të përshpejtuar në mënyrë vendimtare largimin nga hidrokarburet në transport.
- 06** Termocentralet lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3”, me kontratë rreth 336 milionë euro dhe kosto ditore rreth 94 mijë euro, nuk prodhuan energji për mbi një vit për shkak të vonesave në licencim nga ERE.
- 07** Në tremujorin e parë 2026, prodhimi neto arriti 3,647 GWh (+63,2%), importet ranë me 57,4% dhe eksportet bruto u rritën me 105,4% (INSTAT).
- 08** Shqipëria renditet ndër vendet me çmimet më të larta të energjisë për konsumatorët në rajon, rreth 0,18 €/kWh për familjarët në gjysmën e parë të 2025-ës.
- 09** Mbi 6 mijë mjete tërësisht elektrike u regjistruan vetëm në shtatë muajt e parë të 2026-ës, pra +126% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2025-ës; për vitin 2025 rritja ishte +91% (DPSHTRR; INSTAT).
- 10** Flota aktive arriti 1,048,000 mjete në fund të 2025-ës (+9,3%), me raport 361 autovetura për 1 000 banorë (INSTAT, 2025).
- 11** Për herë të parë, sektori privat kalon shtetin në prodhim, rreth 51% e kapacitetit të instaluar kundrejt 48,6% të KESH-it, ku investimet private të akumuluar në burime të rinovueshme vlerësohen mbi 2 miliardë euro.



- 12 Në proces ndërtimi/licencimi ndodhen 10 hidrocentrale të reja me 458 MW, që pritet të rrisin prodhimin kombëtar të energjisë me rreth 31% (ERE).
- 13 Skema e subvencioneve familjare për panele diellore ka përfituar vetëm 4 000 familje rreth 0,5% e familjeve shqiptare (INSTAT, 2022) dhe ka ndikim më shumë social e simbolik sesa strukturor.
- 14 Sipas rastit studimor për një përdorues që përshkon mesatarisht 15,000 km në vit të një automjeti, kostoja vjetore e energjisë për një automjet elektrik rezulton 63%–86% më e ulët se kostoja e karburantit për një automjet me naftë, në varësi të mënyrës së karikimit.

✓ REKOMANDIME

- 1 **Rritja e kapaciteteve të linjave të transmetimit dhe modernizimi i rrjetit** — Ky duhet të jetë investimi i parë dhe më urgjent, rritja e kapaciteteve të linjave të transmetimit duke nisur nga interkoneksioni i ri 400 kV Fierzë–Prizren me Kosovën dhe rehabilitimi i linjës 220 kV Trebinjë–Peruçicë–Podgoricë–Vau i Dejës (të përfshira në listën PEI 2026), si dhe tenderët e OST-së për linja të reja 110 kV është kushti që energjia e re diellore dhe eolike (përfshirë potencialin deri në 2 500 MW të erës në verilindje) të shkarkohet te konsumatori. Pa këto linja, çdo MW i ri prodhues ngec ose humbet para se të arrijë te konsumatori dhe ky investim i paraprin dhe i mbështet të gjithë të tjerët.
- 2 **Përsheptimi i projekteve të ruajtjes së energjisë (storage)** — Përparësi buxhetore dhe rregullatore për projekte si zgjerimi i Moglicës, si dhe nxitja e baterive në shkallë të vogël pranë impianteve diellore, për të zvogëluar varësinë nga importi në momentet e mbrëmjes dhe në ditët me diell të pakët.
- 3 **Zgjerimi i shkallës së skemave të subvencionimit familjar** — Rritja e numrit të familjeve përfituese përtej 2 000 familje/fazë, me kriterë të përparësisë për familjet me të ardhura të ulëta dhe zonat rurale me rrjet të dobët, si mjet i drejtësisë energjetike (energy equity), jo vetëm efikasiteti sasior.




4 Investim i drejtpërdrejtë në uljen e humbjeve të rrjetit — Vendosja e një objekti konkret kohor (për shembull nën 10% deri në 2030) me monitorim publik periodik, pasi çdo pikë përqindjeje e humbjeve të ulura ekuivalon në praktikë me kapacitet prodhues shtesë “falas”. Ky objektiv mbështetet drejtpërdrejt në prioritetin e parë rritjen e kapaciteteve të linjave të transmetimit, pasi humbjet fizike ulen edhe duke transmetuar në tensione më të larta dhe me kapacitet të mjaftueshëm rrjeti.

5 Planifikim territorial për fotovoltaiet dhe modele agro-solar — Prioritizimi i çatave, zonave industriale të braktitura dhe tokave jo-produtive, për projektet në tokë bujqësore të kërkohet vlerësim më i fortë territorial dhe konsultim real me komunitetet. Modelet agro-solar duhet të testohen si mënyrë për të kombinuar prodhimin energjetik me përdorimin bujqësor.


6 Integrimi i elektrifikimit me politikat e mobilitetit urban — Politikat për automjetet elektrike duhet të plotësohen me investime mbështetëse dhe lehtësi të vazhdueshme përtej 2026 për të nxitur rritjen e flotës së automjeteve elektrike.

BIBLIOGRAFIA

1. Monitor.al (2025). 6-mujori 2025, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria me çmimet më të larta të energjisë në rajon. <https://monitor.al/6-mujori-2025-maqedonia-e-veriut-dhe-shqiperia-me-cmimet-me-te-larta-te-energjise-ne-rajon/>
2. AKBN (2025). Strategjia Kombëtare e Energjisë. <http://www.akbn.gov.al/strategjia-kombetare-e-energjise/>
3. Agjencia për Eficencën e Energjisë (2025). Energjia e rinovueshme. <https://eficenca.gov.al/energjia-e-rinovueshme-mie>
4. Agjencia për Eficencën e Energjisë (2025). Thirrja për subvencionimin e paneleve diellore – Programi i dytë. <https://eficenca.gov.al/2025>
5. EBRD (2024). Albania Diagnostic 2024. https://www.ebrd.com/content/dam/ebird_xp/assets/pdfs/country-strategies/albania/Albania%20diagnostic%202024-web.pdf
6. EEA (2025). Europe's Environment – Albania. <https://www.eea.europa.eu/en/europe-environment-2025/countries/albania>
7. Ekofin.al (2026). Shqipëria mund të prodhojë deri në 2500 MW energji nga era brenda vitit 2030. <https://ekofin.al/shqiperia-mund-te-prodhoje-deri-ne-2500-mw-energji-nga-era-brenda-vitit-2030/>
8. Ember (2025). Global Electricity Review 2025. <https://ember-energy.org/latest-insights/global-electricity-review-2025/>
9. INSTAT(2025). Bilanci i Energjisë Elektrike 2025. <https://www.instat.gov.al/media/2b0d1llh/bilanci-i-energjisë-elektrike-2025docx.pdf>



10. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Bidding Documents – Solar Auction. <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Bidding-Documents-English-version.pdf>
11. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. National Energy and Climate Plan (NECP). <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/The-National-Energy-and-Climate-Plan-NECP.pdf>
12. Transport Community (2025). Strategic Framework for Deployment of E-Charging Infrastructure in the Western Balkans. https://www.transport-community.org/wp-content/uploads/2025/12/Final_report_Strategic_framework_for_deployment_of_e-charging_infrastructure_in_the_Western_Balkans.pdf
13. INSTAT (2026). Bilanci i Energjisë Elektrike, Tremujori I 2026 (publikuar më 21.05.2026). https://www.instat.gov.al/media/h35bu5mo/balance-of-electric-power-q1_2026.pdf
14. IEA (2026). National Energy and Climate Plan of the Republic of Albania (përditësuar më 27.04.2026). <https://www.iea.org/policies/30279-national-energy-and-climate-plan-of-the-republic-of-albania>
15. EEA (2025). Albania country profile – Europe's Environment 2025; Renewable energy sources indicator. <https://www.eea.europa.eu/en/europe-environment-2025/countries/albania>
16. European Commission (2023). Albania Report 2023 – Chapter 15: Energy. https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf
17. GlobalPetrolPrices (2026). Çmimet e karburanteve në Shqipëri. <https://www.globalpetrolprices.com/Albania>
18. Monitor.al (2026). Energjia, Balluku: 2 miliardë euro investime private në burime të rinovueshme. <https://monitor.al/energjia-balluku-2-miliarde-euro-investime-private-ne-burime-te-rinovueshme>
19. DPSHTRR (2026). Statistikat e mjeteve elektrike (databazë/dashboard zyrtar). <https://www.dpshttr.al>
20. REPORT TV (2025) Rritja e çmimit të energjisë me mbi 57% për makinat elektrike, taksitë kërkojnë rishikim të vendimit të ERE, <https://shqiptarja.com/lajm/rritja-e-cmimit-te-energjisë-me-mbi-57-për-makinat-elektrike-taksite-kerkoje-rishikim-te-vendimit-te-ere>



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al